



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 243, dt. 18.12.2015

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "*Për trashëgiminë Kulturore*", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.12.2015, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e rrjetit TM 20kV në Paskuqan dhe Babrru, Tiranë. (Loti 5 që shtrihet në zonën administrative të bashkisë Tiranë, kërkesë e OSHEE).
2. Miratimin e projektit për ndërtimin e Nën Stacionit Tec Kombinat 110/20kV Tiranë, kërkesë e OSHEE.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI